

**STATUTI**  
**i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**Jaser**

Personi qe firmos si me poshte:

Arsen Haraçiu, i biri i Kapllanit, i datelindjes 1982-12-12, lindur ne Shqiperi e banues ne Tirane Rruga Hasan Vathi, Godine private nr.9 mbajtes i ID me Nr.personal I21212035B. Ne baze ligjit 9901 per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Krijon Statutin e shoqerise.

Neni 1

Forma, emertimi, objekti, selia dhe kohezgjatja

Krijohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e cila ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Nr. 9901, date 14.04.2008, dhe aktet e tjera ligjore qe jane ne fuqi, gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, si dhe me dispozitat e ketij statuti. Ajo eshte nje person juridik shqiptar, i cili do te ushtroje aktivitetin privat ne territorin e Republikes se Shqiperise pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte

**Jaser**

NENI 3

**Objekti i aktivitetit ekonomik do te jete:**  
Sherbime ne fushen e ndertimit.

NENI 4

Selia e shoqerise **Jaser** Sh.p.k do te jete: Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Koder Kamez, Banese private, Zona Kadastale 2032, Nr.Pasurie 271

NENI 5

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje me afat te pacaktuar. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve

NENI 6

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar inicialet e emertimit te saj

KREU II

Kapitali themeltar, Kontributi, Pjeset e kapitalit themeltar

#### NENI 7

Kapitali fillestar i shoqerise do te jete 100.000(njeqindmije) leke, i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100000 leke. Kapitali themeltar mund te shtohet ose te pakesohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

#### NENI 8

Kapitali themeltar eshte i ndare sipas kontributeve si me poshte:

- Arsen Haraçiu ,1 kuote me 100% te kapitalit fillestar

#### NENI 9

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te shoqerise. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen te treteve vetem me vendim te Asamblese se ortakeve. Ne kete rast eshte e nevojshme te jepet miratimi i Ortakeve ne te njejtat kushte si per ortakun e ri, ne rastin e transferimit te te treteve.

#### NENI 10

Me vendim te asamblese se ortakeve mund te zmadhohet dhe te pakesohet kapitali themeltar, ne perputhje me ligjin e shoqerive tregtare, nr.9901,dt.14.04.2008, sipas nenit 81. Zvogelimi i kapitalit mund te behet kur kjo gje motivohet nga humbjet dhe ne rastet kur nga raporti i eksperti kontabel konkludohet se kapitalet e vete shoqerise, per shkak te humbjeve, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit te shoqerise. Ortake brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne humbjen vendosin mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise.

### KREU III

#### Marrja e vendimeve dhe kontrolli i shoqerise Administrimi

#### NENI 11

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga ortakët ne perputhje me dispozitat e percaktuar ne ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ne lidhje me marrjen e vendimeve ne asamble.

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimarrës

Asambleja e ortakeve ka keto te drejta dhe detyrime:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise

-Ndryshimet e statutit

-Emerimin e shkarkimin e administratoreve

-emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar

- Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur me siper
- Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,pershire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Asambleja e pergjithshme thirret nga adiministratori apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" nr.9901.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve realizohet nepermjet njoftimit me poste elektronike, leter rekomande, te ortakeve nga administratori i shoqerise jo me vone se 7-dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese, duke u njoftuar per daten e mbledhjes, vendin, oren, rendin e dites.

Çdo ortak merr pjese ne marrjen e vendimeve duke disponuar nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit qe ai zoteron.Marrja e vendimeve merret me shumicen e votave per çdo rast,sipas ligjit ne fuqi.

#### NENI 12

- Administratori i shoqerise emerohet Arsen Haraçiu, i biri i Kapllanit, i datelindjes 1982-12-12, mbajtes i ID me Nr.personal I21212035B per nje afat 5 vjecar

#### NENI 13

Administratori i shoqerise ka per detyre:

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme
- Perfaqesoje shoqerine tregtare
- Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- Pergatisi dhe nenshkruajne bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve,i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- Raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare
- Jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme

#### KREU IV

#### NENI 14

Viti financiar, llogarite vjetore, ndarja e fitimit.

Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.  
Llogarit vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raporte e veçanta te hartuara nga eksperti kontabel i regjistruar,miratohen nga Asambleja e Ortakeve.

Miratimi i bilancit vjetor, pasqyrave financiar dhe te dhenat qe lidhen me to, behet brenda 31 Mars te vitit pasardhes, ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi.

#### NENI 15

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket ortakeve te shoqerise sipas pjesmarrjes dhe perqindjes se kuotave te kapitalit Themeltar qe kane depozituar ne Shoqeri. Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te shoqerise, kjo shoqeri pergjigjet deri ne shlyerjen e tyre.

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit te vitit financiar, Asambleja e Ortakeve vendos per krijimin e fondeve, per te ardhurat neto si dhe perdorimit te tyre sipas nevojave te saj.

Fitimit te rezervuar gjate vitit financiar i zbriten po te jete e nevojshme humbjet e meparshme, si dhe shuma e lene menjane per fondin rezerve te domosdoshem 5% e fitimit te çdo viti si rezerve e domosdoshme deri sa tek ky i fundit te arrije vleren e 1/10 te Kapitalit Themeltar.

#### Kreu V

Zgjatja e afatit, prishja, Likujdimi i shoqerise  
NENI 16

Zgjatja e afatit te shoqerise, ose prishja e saj para afatit, vendoset nga Asambleja e Ortakeve.

#### NENI 17

Shoqeria mund te priset me perfundimin e afatit te percaktuar ne kete statut, me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja e afatit, kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet e parashkuara ne ligj.

#### NENI 18

Shoqeria hyn ne procesin e Likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Likujdimi i shoqerise behet me Vendim te Asamblese se Ortakeve, sipas rasteve te parashkuara ne ligjin 9901, date 14.04.2008. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve emeron nje ose disa likujdator, te cilet i paraqesin Asamblese se Ortakeve raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te saj, mbi ndjekjen e procedurave te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshme te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin e procesit te likujdimit .

#### KREU VI

Dispozitat e fundit

#### NENI 19

Shnderrimi i shoqerise ne nje forme tjeter kryhet me vendim te Asamblese se ortakeve.

## NENI 20

Punesimi punetoreve ne shoqeri do te behet mbi bazen e kontratave kolektive ose kontrates individuale te punes. Ne kontraten e punes do te rregullohen keto kushte:

- Kushtet dhe marredhenies se punes
- Fitimin e punes
- Koha e punes
- Mbrojtje ne pune
- Te drejtat dhe detyrimet ne pune
- Paga e punes, shperblimi,etj.
- Pushimi i marredhenies se punes.

## Neni 21

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit,ndermjet shoqerise dhe te treteve ose ortakeve te shoqerise dhe te treteve do te zgjidhen me mirekuptim ndermjet tyre dhe kur mirekuptimi nuk arrihet organi kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjygesor Tirane.

## Neni 22

Per çeshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete statut do te zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## Neni 23

Ky statut eshte hartuar ne 3(tre) kopje origjinale, duke patur fuqi te barabarte ligjore.

### Ortaku Themelues

Arsen Haraçiu

ARSEN HARAGIU

Date 05.07.2017

